



Nr. 433/8 prot.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ELBASANIT "ALEKSANDËR XHUVANI"
BORDI I ADMINISTRIMIT

Elbasan, me 23.02.2024

VENDIM

Nr. 14, datë 23.02.2024

"Për

**vendosjen e tarifave të konkurrimit, tarifave të regjistrimit, tarifave të shkollimit
në të gjitha programet e studimit në Universitetin e Elbasanit "Aleksandër
Xhuvani"**

Në mbështetje të Ligjit nr. 80/2015, datë 22.07.2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", neni nr. 3. Pika 3. ç), neni nr. 6, neni nr. 47, VKM nr. 288 datë 21.05.2018 "Për miratimin e kufirit maksimal të tarifës vjetore të shkollimit për studentët që ndjekin studimet në institucionet publike të arsimit të lartë, në një program të ciklit të parë të studimeve, në një program të integruar të studimeve ose në një program të studimeve profesionale me kohë të plotë", i ndryshuar me VKM nr. 778 datë 26.12.2018, shkresës së MASR nr. 1036 prot, datë 06.02.2020 "Mbi zbatimin e VKM-së nr. 778, datë 26.12.2018", Vendimit të Senatit Akademik nr. 14, datë 23.02.2024 "Për vendosjen e tarifave të konkurrimit, tarifave të regjistrimit, tarifave të shkollimit në të gjitha programet e studimit në Universitetin e Elbasanit 'Aleksandër Xhuvani'", Bordi i Administrimit,

VENDOSI:

1. Tarifa konkurrimi është në vlerën 5,000 lekë për aplikant për konkuresit në Ciklin e parë të studimeve "Bachelor në edukim fizik e sporte".
2. Tarifë regjistrimi:
 - a. Tarifa e regjistrimit në programet me karakter profesional – Pkp, programet e ciklit të parë të studimeve bachelor - Bach, programet e integruara master i shkencave – PiMs është në vlerën 1,600 lekë. Këtë tarifë e paguan çdo kandidat që del fitues dhe regjistrohet në një program studimi në UE. Tarifa e regjistrimit që paguhet nga kandidatët për student, të cilët regjistrohen në një program studimi në UE, por që çregjistrohen në një fazë të mëvonshme nga ky program studimi, për tu regjistruar në një program tjetër brenda UE – së, të paguhet vetëm njëherë. Tarifa e regjistrimit që paguhet nga kandidatët për student, të cilët regjistrohen në një program studimi në UE, por që çregjistrohen në një fazë të mëvonshme nga ky program studimi, për t'u regjistruar në një Universitet tjetër, do të jetë e pakthyeshme.
 - b. Tarifë aplikimi dhe regjistrimi në ciklin e dytë të studimeve; Master profesional - Mp, Master i shkencave – Msh, Program i formimit të vazhduar – Pfv është në vlerën 2,500 lekë. Tarifa e regjistrimit do të paguhet nga kandidatët për student, për secilin program që kandidati regjistrohet për konkurrim në ciklin e dytë në UE. Në momentin që del fitues në një program studimi, nuk do të ketë tarifë tjetër regjistrimi – pra kjo tarifë do të përfshij konkurrimin dhe regjistrimin.



- c. Tarifë aplikimi dhe regjistrimi në ciklin e tretë të studimeve “Doktoratë” të jetë 5,000 lekë. Tarifa e regjistrimit do të paguhet nga kandidatët për student, për secilin program që kandidati regjistrohet për konkurrim në ciklin e tretë në UE. Në momentin që del fitues në një program studimi, nuk do të ketë tarifë tjetër regjistrimi – pra kjo tarifë do të përfshijë konkurimin dhe regjistrimin.
3. Tarifat e shkollimit për të gjitha programet e studimit në Universitetin e Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” të jenë:
- a) Në programet me karakter profesional – Pkp, programet e ciklit të parë të studimeve bachelor - Bach, tarifa vjetore e shkollimit të jetë:
- Për program të parë studimi, në programet me karakter profesional – Pkp, programet e ciklit të parë të studimeve bachelor - Bach, tarifa vjetore e shkollimit është në vlerën 25,000 lekë.
 - Për program të dytë, në programet me karakter profesional – Pkp, programet e ciklit të parë të studimeve bachelor - Bach, tarifa vjetore e shkollimit, tarifa vjetore e shkollimit është në vlerën 60,000 lekë.
 - Për vitin akademik 2023-2024 e në vijim, studentët në program të parë studimi, në programet me karakter profesional – Pkp, programet e ciklit të parë të studimeve bachelor - Bach, që regjistrohen në vitin e parë akademik paguajnë tarifën vjetore të shkollimit në vlerën 12,500 lekë.
 - Për vitin akademik 2023-2024 e në vijim, studentët në program të parë studimi në programet me karakter profesional – Pkp, që studiojnë në vitin e dytë, të cilët kanë notë mesatare të ponderuar 6 (gjashtë) e lart, në vitin akademik paraardhës, si dhe kanë shlyer të gjitha detyrimet e vitit paraardhës akademik, për të cilin llogaritet nota mesatare e ponderuar, të paguajnë tarifën vjetore të shkollimit në vlerën 12,500 lekë. Studentët që rezultojnë me notë mesatare nën 6 (gjashtë) të paguajnë tarifën vjetore të shkollimit në vlerën 25,000 lekë
 - Për vitin akademik 2023-2024 e në vijim, studentët në program të parë studimi në programet e ciklit të parë të studimeve bachelor - Bach, që studiojnë në vitin e dytë e të tretë, të cilët kanë notë mesatare të ponderuar 6 (gjashtë) e lart, në vitin akademik paraardhës, si dhe kanë shlyer të gjitha detyrimet e vitit paraardhës akademik, për të cilin llogaritet nota mesatare e ponderuar, të paguajnë tarifën vjetore të shkollimit në vlerën 12,500 lekë. Studentët që rezultojnë me notë mesatare nën 6 (gjashtë) të paguajnë tarifën vjetore të shkollimit në vlerën 25,000 lekë.
- b) Në programe të integruar të studimeve master i shkencave – PiMs, tarifa vjetore e shkollimit të jetë:
- Për program të parë studimi në programet e integruara master i shkencave – PiMs tarifa vjetore e shkollimit është në vlerën 30,000 lekë.
 - Për program të dytë studimi në programet e integruara master i shkencave – PiMs tarifa vjetore e shkollimit është në vlerën 60,000 lekë.
 - Për vitin akademik 2023-2024 e në vijim, studentët në program të parë studimi në programet e integruara master i shkencave – PiMs, që regjistrohen në vitin e parë akademik të paguajnë tarifën vjetore të shkollimit në vlerën 15,000 lekë.
 - Për vitin akademik 2023-2024 e në vijim, studentët në program të parë studimi në programet e integruara master i shkencave – PiMs, që studiojnë në vitin e dytë, të tretë, të katërt e të pestë, të cilët kanë notë mesatare të ponderuar 6 (gjashtë) e lart, në vitin akademik paraardhës, si dhe kanë shlyer të gjitha detyrimet e vitit paraardhës akademik, për të cilin llogaritet nota mesatare e ponderuar, të paguajnë tarifën vjetore të shkollimit në vlerën 15,000 lekë. Studentët që rezultojnë me notë mesatare nën 6 (gjashtë) të paguajnë tarifën vjetore të shkollimit në vlerën 30,000 lekë.
- c) Në programe të ciklit të dytë të studimeve “Master profesional - Mp”, tarifa për çdo kredit të jetë:
- Për program të parë studimi në vlerën 1,000 lekë/kredit.
 - Për program të dytë studimi në vlerën 1,200 lekë/kredit.
- Tarifa për kredit dhe e përgjithshme e shkollimit për çdo program studimi të jetë sipas tabelës nr. 1.
- d) Në programe të ciklit të dytë të studimeve “Master i shkencave - Msh”, tarifa për çdo kredit të jetë:
- Për program të parë studimi në vlerën 1,200 lekë/kredit.
 - Për program të dytë studimi në vlerën 1,400 lekë/kredit.
- Tarifa për kredit dhe e përgjithshme e shkollimit për çdo program studimi të jetë sipas tabelës nr. 2.
- e) Në programin e formimit të vazhduar, tarifa për çdo kredit të jetë:



- Për program të parë studimi në vlerën 1,000 lekë/kredit.
- Tarifa për kredit dhe e përgjithshme e shkollimit për çdo program studimi të jetë sipas tabelës nr. 3
- f) Tarifa e shkollimit për projektet e trajnimeve të jetë:
 - Tarifë trajnimi 1,000 lekë/kredit.
- g) Në programe të ciklit të tretë të studimeve “Doktoratë”, tarifa e përgjithshme të jetë 450,000 lekë dhe të paguhet me këste të barabartë me nga 150,000 lekë për tre vitet e para të studimeve:
- 4. Studenti i shpallur, sipas rregullores së Universitetit përsëritës në programet me karakter profesional – Pkp, programet e ciklit të parë të studimeve bachelor - Bach, programet e integruara master i shkencave – PiMs;
 - a) Në programet me karakter profesional – Pkp, i shpallur përsëritës në vitin e parë dhe vitin e dytë (nuk ka marrë 20 kredite për të kaluar në vitin pasardhës), të paguajë:
 - Për program të parë studimi në vlerën 25,000 lekë.
 - Për program të dytë studimi në vlerën 60,000 lekë.
 - b) Në programet programet e ciklit të parë të studimeve bachelor - Bach, i shpallur përsëritës në vitin e parë, vitin e dytë dhe vitin e tretë (nuk ka marrë 20 kredite për të kaluar në vitin pasardhës), të paguajë:
 - Për program të parë studimi në vlerën 25,000 lekë.
 - Për program të dytë studimi në vlerën 60,000 lekë.
 - c) Në programet programet të integruar të studimeve master i shkencave – PiMs, i shpallur përsëritës në vitin e parë, vitin e dytë, vitin e tretë, vitin e katërt dhe vitin e pestë (nuk ka marrë 20 kredite për të kaluar në vitin pasardhës), të paguajë:
 - Për program të parë studimi në vlerën 25,000 lekë.
 - Për program të dytë studimi në vlerën 60,000 lekë.
- 5. Studenti që nuk përfundon studimet në programet me karakter profesional – Pkp, programet e ciklit të parë të studimeve bachelor - Bach, programet e integruara master i shkencave – PiMs;
 - a) Në programet me karakter profesional – Pkp në fund të dytë (ka marrë 40 kredite nga viti i parë dhe ka marrë 20 kredite nga viti i dytë), nuk do të paguajë tarifë shkollimi si student përsëritës në vitin dytë, por do të paguajë vetëm për lëndët e vlerësuara me notë jo kaluese në përfundim të vitit akademik të fundit (gjendje në regjistrin themeltar me 30 shtator):
 - për program të parë studimi në vlerën 400 lekë/ kredit,
 - për program të dytë studimi në vlerën 1,000 lekë/ kredit.
 - b) Në programet programet e ciklit të parë të studimeve bachelor - Bach në fund të tretë (ka marrë 40 kredite nga viti i parë, ka marrë 40 kredite nga viti i dytë dhe ka marrë 20 kredite nga viti i tretë), nuk do të paguajë tarifë shkollimi si student përsëritës në vitin tretë, por do të paguajë vetëm për lëndët e vlerësuara me notë jo kaluese në përfundim të vitit akademik të fundit (gjendje në regjistrin themeltar me 30 shtator):
 - për program të parë studimi në vlerën 400 lekë/ kredit,
 - për program të dytë studimi në vlerën 1,000 lekë/ kredit.
 - c) Në programet e integruara master i shkencave – PiMs në fund të pestë (ka marrë 40 kredite nga viti i parë, ka marrë 40 kredite nga viti i dytë, ka marrë 40 kredite nga viti i tretë, ka marrë 40 kredite nga viti i katërt dhe ka marrë 20 kredite nga viti i pestë), nuk do të paguajë tarifë shkollimi si student përsëritës në vitin pestë, por do të paguajë vetëm për lëndët e vlerësuara me notë jo kaluese në përfundim të vitit akademik të fundit (gjendje në regjistrin themeltar me 30 shtator):
 - për program të parë studimi në vlerën 500 lekë/ kredit,
 - për program të dytë studimi në vlerën 1,000 lekë/ kredit.
- 6. Studenti i Ciklit të dytë të studimeve që nuk përfundon studimet brenda kohëzgjatjes së caktuar, pagan tarifën për kreditet e lëndëve të vlerësuara jo kaluese në përfundim të vitit akademik të fundit (gjendje në regjistrin themeltar me 30 shtator).
- 7. Vlera e krediteve të mbartura të paguhet për vlerën totale të lëndëve të vlerësuara jo kaluese, menjëherë para fillimit të sezonit të parë të shlyerjes së detyrimeve mësimore. Kreditet e lëndëve të vlerësuara jo kaluese të krijuara në vijim, pas vitit të fundit akademik (gjendje në regjistrin themeltar me 30 shtator), i



shtohen detyrimeve të prapambetura dhe paguhen para shlyerjes së detyrimeve mësimore, të vitit pasardhës akademik.

8. Tarifa vjetore e shkollimit për programet me karakter profesional – Pkp, programet e ciklit të parë të studimeve bachelor - Bach, programet e integruara master i shkencave – PiMs, të paguhet para fillimit të shlyerjes së detyrimeve mësimore të vitit akademik.
9. Tarifa vjetore e shkollimit për Ciklin e dytë të studimeve, tarifa e përgjithshme të paguhet me këste para shlyerjes së detyrimeve mësimore të çdo semestri.
10. Tarifa vjetore e shkollimit për Ciklin e tretë të studimeve “Doktoratë”, tarifa e përgjithshme të paguhet me këste të barabartë për tre vitet e para të studimeve në fillim të vitit akademik.
11. Studenti për programet me karakter profesional – Pkp, programet e ciklit të parë të studimeve bachelor - Bach, programet e integruara master i shkencave – PiMs, që ka pezulluar studimet apo kërkon të çregjistrohet (nuk ka vijuar në mësim dhe nuk ka shlyer asnjë detyrim mësimor), të mos paguajë tarifë vjetore shkollimi për këtë periudhë. Ky fakt të vërtetohet me dokument nga fakultetet.
12. Studenti i Ciklit të dytë i pajisur me numrin e matrikullimit që kërkon të çregjistrohet nga ky program studimi nuk do paguajë asnjë detyrim financiar, në rast se nuk ka frekuentuar dhe nuk i është shërbyer për shlyerjen e detyrimeve mësimore. Ky fakt të vërtetohet me dokument nga fakultetet
13. Ngarkohet Administratori i Universitetit të Elbasanit “Aleksandër Xhuvani” për zbatimin e këtij vendimi. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

Dr. Ardian DURMISHI



Tabela nr. 1: Tarifat e përgjithshme të shkollimit në “Master profesional”

Nr	Emërtimi i programit	Kredite	Tarifat për kredit		Tarifa e përgjithshme	
			Programi të parë	Programi të dytë	Programi të parë	Programi të dytë
1	Financë	60	1,000	1,200	60,000	72,000
2	Kontabilitet	60	1,000	1,200	60,000	72,000
3	Marketing	60	1,000	1,200	60,000	72,000
4	Administrim-Biznes	60	1,000	1,200	60,000	72,000
5	Ekonomia dhe e drejta në sektorin publik	60	1,000	1,200	60,000	72,000
6	Informatike Ekonomike	60	1,000	1,200	60,000	72,000
7	Gazetar reporter	60	1,000	1,200	60,000	72,000
8	Gazetari sportive	60	1,000	1,200	60,000	72,000
9	Redaktim	60	1,000	1,200	60,000	72,000
10	Menaxhim infermieror	60	1,000	1,200	60,000	72,000
11	Infermieri kirurgjikale	60	1,000	1,200	60,000	72,000
12	Fizioterapi	60	1,000	1,200	60,000	72,000
13	Teknik Imazherie	60	1,000	1,200	60,000	72,000
14	Logopedi	60	1,000	1,200	60,000	72,000
15	Teknik laborator	60	1,000	1,200	60,000	72,000
16	Punonjës social me fëmijët dhe familjen	60	1,000	1,200	60,000	72,000
17	Psikolog në institucione	60	1,000	1,200	60,000	72,000
18	Drejtim dhe administrim arsimit	60	1,000	1,200	60,000	72,000
19	Sherbimi i proves	60	1,000	1,200	60,000	72,000
20	Analist prodhimi	120	1,000	1,200	120,000	144,000
21	Analizë të dhënash	120	1,000	1,200	120,000	144,000
22	Teknologji e informacionit	120	1,000	1,200	120,000	144,000
23	Mësuesi në Arsimin e Mesëm të Ulet për Matematikë-Fizikë me profil minor në Informatikë	120	1,000	1,200	120,000	144,000
24	Mësuesi në Arsimin e Mesëm të Ulet për Matematikë-Informatikë me profil minor në Fizikë	120	1,000	1,200	120,000	144,000
25	Mësuesi në Arsimin e Mesëm të Ulet për Biologji-Kimi me profil minor në Edukim Shëndetësor dhe Mjedisor	120	1,000	1,200	120,000	144,000
26	Mësuesi në Arsimin e Mesëm të Ulet për Gjuhë të Huaj Anglisht me profil minor në Gjuhë Shqipe	120	1,000	1,200	120,000	144,000
27	Mësuesi në Arsimin e Mesëm të Ulet për Gjuhë të Huaj Frengjisht me profil minor në Gjuhë Shqipe	120	1,000	1,200	120,000	144,000
28	Mësuesi në Arsimin e Mesëm të Ulet për Gjuhë të Huaj Italisht me profil minor në Gjuhë Shqipe	120	1,000	1,200	120,000	144,000
29	Mësuesi në Arsimin e Mesëm të Ulet për Gjuhë të Huaj Gjermanisht me profil minor në Gjuhë Shqipe	120	1,000	1,200	120,000	144,000
30	Mësuesi në Arsimin e Mesëm të Ulet për Histori-Gjeografi me profil minor në Edukatë Qytetare	120	1,000	1,200	120,000	144,000
31	Mësuesi në Arsimin e Mesëm të Ulet për Edukatë Qytetare-Histori me profil minor në Gjeografi	120	1,000	1,200	120,000	144,000
32	Mësuesi në Arsimin e Mesëm të Ulet për Edukatë Qytetare-Gjeografi me profil minor në Histori	120	1,000	1,200	120,000	144,000
33	Mësuesi në Arsimin e Mesëm të Ulet për Gjuhë Shqipe dhe Letërsi	120	1,000	1,200	120,000	144,000
34	Mësuesi në Edukim fizik dhe sporte me profil minor në Edukim shëndetësor	120	1,000	1,200	120,000	144,000
35	Mësuesi në Arsimin special	120	1,000	1,200	120,000	144,000

KRYETARI
Dr. Ardian DÛRMISHI



Tabela nr. 2: Tarifatat e përgjithshme të shkollimit në “Master i shkencave”

Nr	Emërtimi i programit	Kredite	Tarifat për kredit		Tarifa e përgjithshme	
			Programi të	Programi të	Programi të parë	Programi të dytë
1	Gjuhësi	120	1,200	1,400	144,000	168,000
2	Trashëgimi kulturore	120	1,200	1,400	144,000	168,000
3	Studime letrare	120	1,200	1,400	144,000	168,000
4	Studime historike	120	1,200	1,400	144,000	168,000
5	Studime gjeografike	120	1,200	1,400	144,000	168,000
6	Matematike e zbatuar	120	1,200	1,400	144,000	168,000
7	Mbrojtje mjedisi	120	1,200	1,400	144,000	168,000
8	Ekonomiadhe e drejta në tregjet ndërkombëtare	120	1,200	1,400	144,000	168,000
9	Marketing	120	1,200	1,400	144,000	168,000
10	Drejtim bankar	120	1,200	1,400	144,000	168,000
11	Menaxhim	120	1,200	1,400	144,000	168,000
12	Kontabilitet dhe Auditim	120	1,200	1,400	144,000	168,000
13	Informatikë ekonomike	120	1,200	1,400	144,000	168,000
14	Psikologji edukimi	120	1,200	1,400	144,000	168,000
15	Sherbime sociale	120	1,200	1,400	144,000	168,000
16	Mesuesi per Arsimin Fillor	120	1,200	1,400	144,000	168,000
17	Infermieri	120	1,200	1,400	144,000	168,000
18	Mami	120	1,200	1,400	144,000	168,000

KRYETARI

Dr. Ardian DURMISHI

